



## Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në çështjen gjyqësore për krime lufte *Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi*, më 21 janar Trupi Gjyqësor hodhi poshtë kërkesën e përbashkët të ekipeve të Mbrojtjes për leje për apelim të një vendimi të mëparshëm të Trupit Gjyqësor, konkretisht që disa deklarata dëshmitarësh të pranohen si prova vetëm në formë të shkruar.

Megjithëse ekipet e Mbrojtjes nuk kundërshtuan që deklaratat e dëshmitarëve në fjalë të pranoheshin në formë të shkruar, ata nuk ishin të pajtimit që Trupi Gjyqësor nuk i lejoi t'i shtonin disa prova njëjës prej deklaratave. Sipas mendimit të tyre, provat shtesë do t'i ofronin Trupit Gjyqësor përshtetë të vërtetë të dëshmisë së dëshmitarit në fjalë. Trupi Gjyqësor vuri në dukje se ai nuk ka marrë vendim mbi pranueshmërinë e provës së propozuar nga Mbrojtja, por konstatoi se përgjigjja e Mbrojtjes ndaj kërkesës së Prokurorisë nuk është mënyra e përshtatshme për të kërkuar pranimin e provave. Trupi Gjyqësor theksoi se Mbrojtja mund të kërkojë pranimin e provës në fjalë sipas Rregullores dhe se Trupi Gjyqësor më pas do të vendosë mbi pranueshmërinë e saj.

Këtë javë, dy dëshmitarë dhanë dëshmi në gjykatë në këtë çështje gjyqësore. Dëshmitari i parë, Hansjorg Strohmajer (Hansjoerg Strohmeyer) ishte këshilltar ligjor i Përfaqësuesit Special të Përkohshëm të Sekretarit të Përgjithshëm të Misionit të OKB-së në Kosovë nga qershori deri në shtator 1999. Dëshmitari i dytë, Xhon Klark (John Clarke) është patolog ligjor, i cili dha dëshmi si dëshmitar ekspert. Dëshmitë e tyre u zhvilluan kryesisht në seancë publike. Këtë pasditë ka nisur dëshminë dëshmitari i ri. Sipas Prokurorisë, ky dëshmitar ka shërbyer si mjek i KFOR-it gjerman në Kosovë midis qershorit dhe gushtit 1999.

Deri më sot 115 dëshmitarë kanë dhënë dëshmi në gjykatë në këtë çështje gjyqësore.

Seanca e ardhshme në këtë çështje gjyqësore është caktuar për të hënë, 27 janar, duke filluar në orën 9 paradite.

Në çështjen gjyqësore *Sabit Januzi, Ismet Bahtijari dhe Haxhi Shala*, më 16 janar, Trupi Gjyqësor urdhëroi Prokurorinë dhe Mbrojtjen të parashtrojnë deri më 24 janar të gjithë materialin provues relevant që mund të ndihmojë Trupin Gjyqësor të përcaktojë nëse ekziston bazë faktike e mjaftueshme për vërtetimin e veprave penale dhe pjesëmarrjen e të akuzuarve në to.

Rregullorja e Procedurës dhe e Provave përcakton se Trupi Gjyqësor mund të miratojë një marrëveshje për pranimin e fajësisë në qoftë se bindet se ekziston bazë faktike e mjaftueshme për vërtetimin e veprës penale

1





dhe pjesëmarrjen e të akuzuarit; se i akuzuari kupton plotësisht marrëveshjen për pranimin e fajësisë dhe pasojat e saj dhe se është pajtuar me vullnet të lirë me këtë marrëveshje dhe pranon faktet në lidhje me akuzat që përfshihen aty.

Versionet e redaktuara publike të dosjeve paraprake të Sabit Januzit dhe Ismet Bahtijarit dolën më 17 dhe 20 janar 2025.

Më 21 janar, Trupi Gjykses lëshoi versionin e redaktuar publik të Vendimit të 7 tetorit 2024 për të hedhur poshtë një pjesë të kërkesës së Mbrojtjes së Bahtijarit për ekzaminim mjekësor të z. Bahtijari në lidhje me argumente mbrojtëse të mundshme.

Sa i takon synimit të Mbrojtjes për mbledhjen e provave mjekësore për argumentet e saj, Trupi Gjykses rikujtoi se, sipas Rregullores së Ndihmës Juridike, Mbrojtjes i akordohet një fond për të marrë konsulentë të jashtëm, ku mund të përfshihen ekspertët. Për këtë arsye, është përgjegjësi e Mbrojtjes të mbledhë prova që i nevojiten për argumentet e saj, përfshirë prova mjekësore për të mbështetur argumente mbrojtëse të mundshme gjatë gjykimit.

Në çështjen gjyqësore *Pjetër Shala*, më 14 janar, Trupi Gjykses miratoi një kërkesë të Mbrojtjes për zgjatje të afatit për dorëzimin e njoftimit për apel në lidhje me Urdhrin për Zhdëmtim, deri më 28 janar 2025. Trupi Gjykses miratoi të njëjtën zgjatje afati për Mbrojtësin e Viktimave, në qoftë se ai dëshiron të dorëzojë njoftim për apel.

Trupi Gjykses theksoi rëndësinë e aspekteve të trajtuara në Urdhrin për Zhdëmtim dhe pranoi se çdo proces apeli kundër një urdhri për zhdëmtim në këtë çështje gjyqësore do të jetë i pari para Dhomave të Specializuara dhe, rrjedhimisht, mund të shërbejë si precedent i rëndësishëm.

